

VENDIM
Nr.78, datë 2.2.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.786, DATË 29.9.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE, “MASTER I SHKENCAVE”, PËR VITIN AKADEMIK 2010 - 2011”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.786, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2010 - 2011, të jenë 6715. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave” | 6525; |
| b) Kuotat për programe të dyta studimi | 0; |
| c) Kuotat për transferimin e studimeve | 100; |
| ç) Kuotat për të huajt | 50; |
| d) Kuotat për të verbrit | 20; |
| dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët | 20.”. |

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:

- a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”, për aplikantët brenda territorit të vendit, 5873;
- b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”, për aplikantët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit 652.”.

3. Tabelat nr.1/1 dhe nr.2/1, që i bashkëlidhen vendimit në fuqi, zëvendësohen me tabelat nr.1/1 dhe nr. 2/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha